



FOTO: PROJEKTI ZHVILLIMI I EKO-TURIZMIT NË ALPET BALLKANIKE

PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT - BULETINI

IPA Programeve të
Bashkëpunimit ndërkufitar
Mal i Zi - Shqipëri dhe Mal i
Zi - Kosovë 2014- 2020

Prill
2019

PËRMBAJTJA

Edicioni i katërt i buletinit të programeve IPA të Bashkëpunimit ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë

Edicioni i katërt i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë* 2014-2020.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA BNK Mal i Zi - Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi - Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

Bashkimi Evropian
e përbashkët teknike të programeve IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi - Kosovë 2014-2020

- » Lajme nga projektet e financuara në kuadër të Thirrjes së I-rë të IPA Programit BNK Mal i Zi - Shqipëri2
- » Lajme nga projektet e financuara në kuadër të Thirrjes së I-rë të IPA Programit BNK Mal i Zi - Kosovë.....4
- » Konferenca solemne me rastin e shpalljes së Thirrjes së Dytë në kuadër të IPA Programit BNK Mal i Zi - Kosovë.....6
- » Konferenca solemne me rastin e shpalljes së Thirrjes së Dytë në kuadër të IPA Programit BNK Mal i Zi - Shqipëri.....6
- » Sesionet informuese në kuadër të programit Mal i Zi - Kosovë7
- » Sesionet informuese në kuadër të programit Mal i Zi - Shqipëri.....8
- » Takimi i Shtatë i Komitetit të Përbashkët të Projektit u mbajt në Budvë8
- » Ditët informuese/Forumet për kërkimin e partnerëve për projekte.....8

* Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RSKB 1244 dhe Opinioni e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



MNE - ALB

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI 2014-2020



MNE - KOS

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020

Lajme nga projektet e financuara në kuadër të Thirrjes së I-rë të IPA Programit BNK Mal i Zi - Shqipëri

Vizitë në Zhabjak, Nikshiq, Kollashin dhe Podgoricë

Stafi i projektit *Ana Femërore e Cilësisë* ka organizuar gjatë muajit prill të vitit 2019 vizitë studimore të përbashkët prodhuesve nga Zhabjaku, Nikshiq, Kollashini dhe Podgorica. Gratë e papunësuar nga Ulqini dhe Mirdita patën mundësinë të njihen me prodhimin bujqësor, veçanërisht me bujqësinë organike që kombinon traditën dhe inovacionin.



Vizitat studimore do të kontribuojnë në rritjen e njohurive, vendosjen e kontakteve dhe aplikimin e shembujve më të mirë nga praktika e përditëshme për nevojat e familjeve të tyre. Projekti zbatohet nga Komuna e Ulqinit, Grupi monitores Ulqin – MogUL, Qendra UET dhe Bashkia Mirditë.

Ligjerata mbi mbrojtjen e mjedisit për fëmijët nga Malësia e Madhe dhe Berana

Gjatë muajit mars të vitit 2019, në hapësirat e shkollave fillore "Prekë Gjoni" në Bajzë, dhe "Rifat Nuzi" në Reç (Shqipëri), „Vuk Karaxhiq“ dhe „Vukashin Radunoviq“ në Berane, mbi 400 nxënës moren pjesë në ligjerata dhe fituan fletëpalosjet me informata të vlefshme lidhur me grumbullimin e ndarë të mbeturinave. Ligjeratat edukative janë mbajtur mbi mbrojtjen e mjedisit duke u fokusuar në rëndësinë e riciklimit dhe zvoglimit të sasisë së mbeturinave dhe grumbullimin e ndarë të mbeturinave. Përveç kësaj, në Shqipëri janë ndërmarrë aksionet e pastrimit të oborreve të shkollave së bashku me nxënës, me qëllim që të zbatohen njohuritë e fituara në praktikë.

Maja Peshiq, udhëheqësja e projektit në komunën e Beranes, theksoi që „Rezultati parësorë përfundimtar i dëshiruar i aktiviteteve edukative për nxënësit është rritja e shkathtësive ekologjike. Nëpërmjet një sërë seminaresh interaktive, nxënësve u

prezantohen përvojat që inkurajojnë zhvillimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që janë të nevojshme për përgjegjësinë ekologjike“.

Ligjeratat ishin pjesë e aktiviteteve të projektit *Ishujt e gjelbërt* i cili zbatohet nga Komuna e Beranes dhe CARITAS i Malit të Zi, bashkë me VIS Albania dhe bashkinë Malësi e Madhe nga Shqipëria.

Trajnimet mbi rastet e përmbytjeve dhe ujrave të rrëmbyeshëm u organizuan në Shkodër

Në kuadër të projektit *Fatkeqsitë natyrore nuk njohin kufinj* u organizua me datë 1 prill të vitit 2019 ushtrimi demonstrues ndërkufitar mbi temën e mbrojtjes dhe shpëtimit në rast të përmbytjeve në të cilat 28 pjesëmarrës nga Mali i Zi dhe Shqipëria testuan dhe treguan gatishmërinë për t'iu përgjigjur rasteve të përmbytjeve dhe reagimeve në ujëra të shpejta në bazë të sistemit Rescue 3.

Ushtrimet ishin të paraprirë nga një trajnim katër-ditor i shpëtimtarëve nga këto dy vende, gjatë të cilit pjesëmarrësit patën mundësinë të mësojnë nga instruktorët e licencuar nga Shërbimi i Shpëtimit Malor Kroat mbi metodat moderne të mbrojtjes dhe shpëtimit në rastet e përmbytjeve dhe në ujërat e shpejta. Në bazë të vlerësimit nga instruktorët, gjithësejt 25 pjesëmarrës të cilët gjatë trajnimit zotëruan kërkesat dhe aftësitë

e që parashtrihen nga ky lloj trajnimi, morën certifikatat ndërkombëtare Rescue 3. Projekti zbatohet nga FORS Montenegro, Ministria e Punëve të Brendshme e Malit të Zi - Drejtoria për Emergjencat dhe Prefektura Shkodrë.



U mbajt punëtorja mbi dekorimin e brendshëm të shtëpive familjare

Në prill të vitit 2019 janë organizuar punëtori mbi dekorimin e brendshëm të shtëpive familjare të cilët janë të angazhuar në turizëm rural. Punëtorja u mbajt nga ana e përfaqësuesve të asociacionit Creative nga Berana. Pjesëmarrësit e punëtorisë ishin familjet nga komunat e Beranes, Petnjicës, Andrijevicës, Plavës dhe Gucisë.

Në puntori u diskutua mbi menaxhimin e ekonomive familjare që ofrojnë shërbime në fushën e turizmit, si dhe mbi mënyren se si t'u kalojnë mysafirëve të tyre frymën e traditës dhe mikpritjes së zonave respektive. Në muajtë në vijim do të punohet në aspektin që shtëpitë e këtyre familjeve të dallojnë në



bazë të imazhit dhe të përputhen me pejsazhin kulturor të zonës ndërkufitare.

Punëtoritë janë organizuar në kuadër të projektit *Ruajtja e peisazheve kulturore në Shqipëri dhe Mal të Zi* i cili zbatohet nga Muzeu Polimje në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit Rajonal në Bjelastica, Komovi dhe Prokletije, Këshillin e Qarkut Shkodër dhe Euro Partners.



Prodhuesit e ardhshëm shqiptarë vizituan Petnjicën

Në Petnjicë u organizua një vizitë studimore e prodhuesve shqiptarë të mjedrës tek prodhuesit malazezë. Qëllimi i vizitës studimore ishte shkëmbimi i përvojave ndërmjet prodhuesve të rinj të mjedrës në rajonin ndërkufitar.



Vizita studimore është organizuar në kuadër të projektit *Të Rinjtë Malazez dhe Shqiptarë për kulturën e Lule Mjadrës* i cili zbatohet nga Komuna e Petnjicës, Shoqata Kombëtare e prodhuesve të manaferrave, Shkolla e Mesme Petnjicë, Shkolla e Mesme profesionale kombëtare "Ndre Mjeda" dhe NGO COSPE Shqipëri.



Gjatë vizitës ishin të pranishëm edhe ekspertët për prodhimin e mjedrës të cilët kanë ndarë këshillime teknike dhe praktike që mund të zbatohen në sezonin e ardhshëm kultivues.

Trajnime modulare në Shqipëri dhe Mal të Zi

Një sëri e trajnimeve modulare për përfaqësuesit e organizatave turistike, komunave, parqeve nacionale, si dhe për përfaqësuesit e sektorit civil janë organizuar në Shkodër dhe Tivar. Gjatë diskutimit dhe pjesëmarrjes aktive, pjesëmarrësit shkëmbyen mendimet dhe përvojat e tyre mbi atë që nevojitet për të zhvilluar produkte në lidhje me karakteristikat e destinacionit. Poashtu është biseduar mbi atë se si turizmi dhe aktorët lokalë mund të mbështesin zhvillimin e produkteve, cilët janë shembujt e praktikave më të mira nga BE-ja, si dhe si të zhvillohet produkti/bashkëpunimi ndërkufitar në fushat e mbuluara nga projekti. Trajnimet janë organizuar në kuadër të projektit *Turizëm miqësorë për fëmijët në rajonin ndërkufitarë* i cili zbatohet nga Shoqata për Prosperitet Demokratik – Zid nga Mali i Zi dhe Qendra Fëmijët Sot nga Shqipëria.



Mbledhja e recetëve dhe aplikimi i tyre në praktikë

Pas ngritjes së kapaciteteve të gjellëbërësve lokalë në Shqipëri, për çfarë është folur në botimin e mëparshëm, në kuadër të projektit *Kuzhina lokale si ofertë turistike e rajonit ndërkufitarë*, është organizuar trajnimi për gjellëbërësit malazezë. Për më tepër, për të siguruar paraqitjen e njohurive të mbledhura tek publiku, do të përgatitet një libër Gatimi me receta tradicionale.



Përgatitja dhe fotografimi i pjatave u bë në prill të vitit 2019. Libri do të jetë në formën e një botimi me receta të mbledhura nga rajoni, me një pasqyrë në historinë e vetë recetave.

Filluan gërmimet në Tumaricë (Beranë)

Gërmimet arkeologjike filluan në *Tumarica Castrum* në Mal të Zi. Ky lokalitet është qytet i lashtë i fortifikuar i kohës së vonshme antike



dhe kohës së herëshme bizantine, që ndodhet në luginën jugore të fshatit Donja Rzhanica.

Gërmimet në Shqipëri, në Basilikën e herëshme krishtere në Hot në Kastrat (Malësi e Madhe) do të fillojnë gjatë muajit maj. Këto aktivitete zbatohen në kuadër të projektit *Ritja e bashkpunimit – nga antikvitetet kristiane drejt përmirësimit të turizmit* të cilin e zbatojnë Dioçeza e Budimljës dhe Nikshiqit e Kishës Ortodokse Serbe dhe Muzeu Polimlje nga Mali i Zi, dhe ACA -Albania Community Assist në bashkpunim me Institutin e Arkeologjisë, Qendra Shqipëtare e Studimeve nga Shqipëria.



Lajme nga projektet e financuara në kuadër të Thirrjes së I-rë të IPA Programit BNK Mal i Zi - Kosovë

Trajtimi i mbetjeve të ngurta për kushte më të mira në Plavë dhe Gjakovë

Stafi i projektit *Iniciativa të përbashkëta ndërkuftare për menaxhim më të mirë të mbeturinave* ka prezentuar aktivitetet me 13 mars të vitit 2019 në Plavë. Gjatë prezantimit, drejtori i Ndërmarrjes komunale të Plavës **Alen Pejçinoviç**, theksoi se rëndësia e mbrojtjes së mjedisit është në rritje dhe më e dukshme, duke marrë parasysh angazhimin strategjik të Qeverisë së Malit të Zi dhe Kosovës për t'u bashkuar Zonës Ekonomike Evropiane (EEA) dhe për t'u bashkuar BE-së. Ai tha se *“Zgjidhjet jo adekuate për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve natyrore, si dhe faktori njerëzor, kanë kontribuar në identifikimin e këtij problemi në të dy komunitetet”*.

Drejtori i Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “Çabрати” nga Gjakova, **Berat Hadri**, shprehu kënaqësinë e tij me bashkëpunimin me partnerët nga Plava në një projekt të tillë.



Për më tepër, menaxheri i projektit, **Predrag Shqekiq**, ka prezentuar aktivitetet e projektit duke theksuar prokurimin e dy sistemeve për trajtimin e mbetjeve të ngurta, edukimin e qytetarëve, si dhe punëtorinë për të punësuarit e ndërmarrjeve lidhur me përdorimin e sistemeve.

Ai veçanërisht vuri në dukje rëndësinë e edukimit të banorëve më të rinj të Plavës dhe Gjakovës në fushën e mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, si dhe menaxhimin e mbeturinave.

Paralajmërimi i „Hackerspace“

„Hackerspace“ do të themelohet dhe do të jetë në shfërtëzim për qytetarët e Pejës, Istogut, Deçanit, Podgoricës, Rozhajës dhe Beranës. „Hackerspace“ është pjesë e aktiviteteve të projektit *Vetëpunësimi i të rinjve dhe sipërmarrjet sociale*, të cilin është duke e zbatuar Asociacioni për Prosperitet Demokratik – Zid nga Mali i Zi në bashkpunim me partnerët e tij Qendren për aftësi kreative nga Mali i Zi dhe OJQ Lens dhe Qendren Liberale Demokratike nga Kosova. Projekti do të inkuadrojë të rinjtë e papunësuar nga Mali i Zi dhe Kosova, si dhe prindërit e tyre.

FAKTE – HACKERSPACE

“ E thjeshtësuar, “hackerspace” është hapësirë pune e zakonshme ku mund të merreni me projekte që nuk mund të filloni vet, sepse nuk keni hapësirë apo burime të nevojshme për të punuar”. – Lifehacker AU

Punë në sektorin bujqësor për një të ardhme më të mirë të rajonit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Kosovës

Projekti *Punë në sektorin bujqësor për një të ardhme më të mirë të rajonit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Kosovës* ka filluar me aktivitetet. Projekti është dedikuar për krijimin e vendeve të reja pune në sektorin e bujqësisë në rajonin ndërkufitarë. Qëllimi i projektit është themelimi i një koalicioni me bujqit lokal për përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe njohurive në këtë sektor. *„Synimi ynë është që të avancojmë gjendjen duke u bazuar në burimet ekzistuese, sidomos atyre njerëzore, me qëllim që të mundësojmë një jetë më të mirë për komunitetet lokale dhe besojmë që partneritetet e krijuara paraqesin bazë të mirë për ardhmërinë e komuniteteve rurale”*, shprehu kordinatori i projektit **Miodrag Ivanoviç** nga komuna e Andrijevicsë.



Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore

Gjatë dy muajve të parë, në kuadër të projektit CARES - Veprimet ndërkufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues, është përgatitur një hulumtim fillestar mbi njohuritë e grave lidhur me shëndetin riprodhues dhe një broshurë mbi temën e ruajtjes së shëndetit riprodhues. Është përgatitur një identitet vizual i projektit, i cili do të ndjekë fushatën informative dhe janë kontaktuar përfaqësuesit e institucioneve përkatëse shëndetësore në lidhje me çështjet e prokurimit të pajisjeve, hulumtimit dhe zhvillimit të broshurës si dhe zbatimit të aktiviteteve të tjera të projektit.

Projekti zbatohet nga FORS Montenegro dhe ECMI Kosovë. Projekti synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, rritjen e vetëdijes për rëndësinë e kontrolleve të rregullta preventive dhe krijimin e shprehisë së parandalimit. Aktivitetet zbatohen në Andrijevicë, Beranë, Bijello Pole, Guci, Petnjicë, Plavë, Kollashin, Mojkovac, Rozhajë, Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Gjakovë.



Nadi vremena. Spriječi. Živi.

Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet balkanike

Parku Nacional Prokletije në Mal të Zi dhe Parku Nacional Bjeshkët e Nemuna në Kosovë po bëhen destinacioni i preferuar për një numër gjithnjë e më të madh turistësh, sidomos dashamirëve të natyrës dhe alpinizmit. Për të inkurajuar promovimin e potencialit të kësaj zone, si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit ndërkufitar,

nëpërmjet potencialeve të përbashkëta turistike të bazuara në trashëgiminë natyrore dhe kulturore, fillojë zbatimimi i projektit *Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet balkanike*.

Stafi i projektit ka realizuar 55 intervista me ofruesit lokal të shërbimeve turistike me qëllim të identifikimit të potencialit më të mirë të zhvillimit të turizmit në të gjitha segmentet.



Projekti zbatohet nga Qendra për Mbrojtjen dhe Hulumtimin e Zogjve së bashku me Shërbimin e shpëtimit malor të Malit të Zi, Qendrën Kosovare për Avokim dhe Zhvillim dhe Shoqërinë Bjeshkatore Alpiniste "Pashtriku".

Takimet fillestare me partnerët në Gjakovë

Gjatë periudhës janar – mars të vitit 2019 janë organizuar takime konsultative me Kompaninë rajonale për menaxhimin e mbeturinave „Çabрати", zyrtarët për çështjen e arsimit në Gjakovë, drejtorin e shkollës ekonomike "Kadri Kusari" dhe shkollës fillore "Fehmi Agani" nga Gjakova. Stafi i projektit *Të bashkuar kundër ndotjes*, kishte për qëllim që të njoftojë akterët me aktivitetet e projektit dhe të sigurojë bashkëpunimin më të mirë me shkollat fillore dhe të mesme

Projektin e zbatojnë Komuna e Gjakovës, "Let's Do It Peja", Komuna e Petnjicës dhe

Qendra për Zhvillim Rajonal – Rozhajë.



300 km shtigje biçikletash

Projekti *Bjeshkët e Nemuna – destinacion tërheqës natyror* synon të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të zonës së Bjeshkëve të Nemuna si një destinacioni turistik në natyrë. Aktivitetet përgatitore në kuadër të projektit kanë filluar. Projekti parashikon ngritjen dhe zhvillimin e shtigjeve për alpinizëm dhe çiklizëm në gjatësi prej 300 km, instalimin e 10 hapësirave për parkim biçikletave, pajisjen e jashtme dhe vendosjen e sinjalizimit për 30 panorama, 50 zona pushimi dhe 50 burime ujore. Përveç kësaj, parashikohet të krijohen shtigje tematike dhe për ngjitje për lidhjen e rrugëve ekzistuese në të dy anët e kufirit. Po ashtu është planifikuar organizimi i dy panairëve ndërkufitare për promovimin e turizmit në natyrë së bashku me aktivitetet të tjera promovuese me qëllim promovimi të ofertave turistike.

Projekti po zbatohet nga muaji shkurt i vitit 2019 nga Agjencia Rajonale e Zhvillimit Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije, Organizata Turistike e Plavës, Agjencia e Zhvillimit Rajonal - Perëndimi (AZHR-Perëndim) dhe Komuna e Pejës.

Burimi: Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet balkanike: Liqeni i Hridit (Bjeshët e Nemuna)



Konferenca solemne me rastin e shpalljes së Thirrjes së Dytë në kuadër të IPA Programit BNK Mal i Zi - Kosovë

Konferenca solemne me rastin e shpalljes së Thirrjes së Dytë në kuadër të Programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë u mbajt me datë 29 janar të vitit 2019 në Prishtinë. Udhëheqësja e Strukturës operative në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, **Rozafa Ukimeraj**, i përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit dhe theksoi se bashkëpunimi në mes të Malit të Zi dhe Kosovës filloi në vitin 2010 dhe që sot ekzistojnë të produkte konkrete si rezultat i këtij bashkëpunimi.



Ajo falenderoj strukturat operative të programit, Delegacionin e Bashkimit Evropian në Mal të Zi, Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Sekretariatit e Përbashkët Teknik, të cilët bënë përpjekjet e tyre për të arritur këto rezultate. Po ashtu, inkurajoi të gjithë aplikantët potencialë që të konsiderojnë hartimin e projekteve të përbashkëta me komunat dhe institucionet komunale që janë pjesë e Programit, pasi ato garantojnë qëndrueshmëri më të madhe të projekteve pas përfundimit të zbatimit.

Vuçiq Qetkoviq, Shefi i Strukturës Operative të Malit të Zi, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkuftar me Kosovën dhe shprehu kënaqësinë e tij me faktin se sot është promovuar Thirrja e Dytë në kuadër të Programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë 2014-2020. Ai vlerësoi se bashkëpunimi i mirë midis këtyre dy vendeve rezultoi në kontraktimin e shtatë projekteve brenda Thirrjes së parë, me vlerë totale prej 2.02 milion euro.



Ai kujtoi se në kuadër të Thirrjes së Parë, gjithësej 75 projekt-propozime u dërguan dhe fondet e kërkuara ishin 10 herë më të larta sesa ato që ishin në dispozicion, gjë që tregon nevojën dhe interesin e përfutësve potencial në të dy anët e kufirit për të zbatuar së bashku projekte që do të kontribuojnë në përmirësimin e standarteve dhe cilësisë së jetës së njerëzve në zonën kufitare, që është gjithashtu një nga qëllimet themelore të programit. Ai informoi pjesëmarrësit se kjo Thirrje është përqendruar në dy prioritetet tematike të lidhura me punësimin, mobilitetin e punës dhe përfshirjen sociale dhe kulturore në të dy anët e kufirit, si dhe me promovimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore, me fonde prej 2.04 milion euro në dispozicion, dhe se afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 prill 2019.

Me këtë rast, **Agron Hoti**, përfaqësues i zyrës së NIPAC-ut në Ministrinë e Integritimit Evropian të Kosovës, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për interesimin e tyre dhe shprehu bindjen se tendenca e interesit të lartë të aplikuesëve potencial do të vazhdojë. Ai shpresoi që brenda kësaj thirrjeje do të ketë ide të suksesshme dhe projekte që do të jenë të qëndrueshëm dhe që do të sjellin përfitime për qytetarët që jetojnë në zonën ndërkuftare.



Në emër të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, **Luigi Bruca**, kreu i Departamentit për Bashkëpunim, vlerësoi suksesin e vazhdueshëm të Malit të Zi në programet dypalëshe, pasi që kjo tashmë është Thirrja e tretë e shpallur me radhë në kuadër të programeve të perspektivës së re financiare. Ai shtoi se është përparim veçanërisht i lavdërueshëm, duke pasur parasysh se Ministria e Financave e Malit të Zi, në bashkëpunim me Zyrën për Integritet Evropian, merret me kontraktimin e fonde evropiane nën menaxhimin indirekt. Ai theksoi se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e Republikës së Kosovës është provuar të jetë një partner i suksesshëm dhe se ka bashkëpunim të mirë mes dy vendeve. Ai i informoi pjesëmarrësit se Bashkimi Evropian për perspektivën 2014-2020 ka ndarë 8.4 milionë euro për

mbështetje dhe projekte brenda këtij Programi për prioritetet tematike të lidhura me punësimin, turizmin dhe mbrojtjen e mjedisit. Pas fjalëve hyrëse, **Sanja Todoroviq**, drejtuese e Sekretariatit të përbashkët teknik, shkurtimisht prezantoi qëllimet, fondet dhe rregullat e përgjithshme të Thirrjes së dytë. Konferenca u ndoq nga gjithësej 119 pjesëmarrës nga të dyja anët e kufirit duke përfaqësuar strukturat operative, komunat, institucionet/ndërmarrjet lokale dhe kombëtare, institucionet arsimore, sektorin e shoqërisë civile dhe mediat.

Konferenca solemne me rastin e shpalljes së Thirrjes së Dytë në kuadër të IPA Programit BNK Mal i Zi - Shqipëri

Strukturat operative të programit, Zyra për Integritet Evropian e Malit të Zi, Autortiteti kontraktues (CFCU i Malit të Zi) dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, me mbështetjen e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programit, kanë organizuar në Podgoricë konferencën solemne më 18 mars të vitit 2019 me rastin e shpalljes së Thirrjes së Dytë për projekt-propozime në kuadër të IPA Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Shqipëri 2014-2020.



Konferenca u hap nga Zëvendës Kryenegociatorja dhe Koordinatorja Kombëtare e IPA, **Ivana Glisheviq Gjuroviq**, e cili theksoi se Thirrja e Dytë do të jetë e hapur deri më datën 27 maj të vitit 2019 për projekt-propozime që duhet të kontribuojnë në mbrojtjen e burimeve natyrore në zonat e liqenit dhe maleve dhe forcimin e punësimit dhe përfshirjes sociale. Ajo vlerësoi se bashkëpunimi cilësorë midis dy vendeve rezultoi në kontraktimin e tetë projekteve me vlerë prej 3.2 milion euro në kuadër të Thirrjes së Parë për dërgimin e projekt-propozimeve, të cilët kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së njerëzve në zonën e programit duke ndikuar në fushën e promovimit të turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore, mbrojtjes së mjedisit, si dhe punësimit. **Glisheviq Gjuroviq** u rikujtoi pjesëmarrësve se brenda thirrjes së parë janë

dërguar gjithsej 82 projekt- propozime, me 9 herë më shumë fonde të kërkuara sesa ishin në dispozicion, gjë që tregon nevojën dhe interesin e përfituesve potencialë në të dy anët e kufirit për të zbatuar së bashku projekte që do të kontribuojnë në përmirësimin e standardeve dhe cilësisë e jetës së njerëzve në zonën kufitare, që është gjithashtu një nga qëllimet kryesore të programit.



Zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, **Sokol Dedja** theksoi se programi po zbatohet me shumë sukses dhe shprehu besimin se projektet e ardhshme do të kontribuojnë me rezultate konkrete, të cilat janë të rëndësishme për jetën e qytetarëve në zonën kufitare. Përveç kësaj, ai theksoi se është shumë e rëndësishme për të forcuar partneritetet ndërmjet njerëzve dhe institucioneve në zonën kufitare.



Në emër të Autoritetit Kontraktues, Ushtruesja e detyrës së Drejtoreshës së Drejtorisë së Financave dhe Kontraktimit për Asistencën e Fondeve të BE-së nga Ministria e Financave të Malit të Zi, **Marija Vukçeviq**, theksoi se kjo është tashmë thirrja e katërt në kuadër të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar nga perspektiva financiare e IPA II, e cila zbatohet përmes menaxhimit indirekt të fondeve të Bashkimit Evropian. Kjo do të thotë që roli i Autoritetit Kontraktues ushtrohet nga Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Fondeve të Asistencës së BE-së brenda Ministrisë së Financave dhe kjo Thirrje po ashtu do të zbatohet në mënyrë të pavarur nga institucionet e sistemit, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Komisioni Evropian. Ajo gjithashtu theksoi gatishmërinë e plotë për të ndërtuar një partneritet me aplikantët dhe

përfituesit e ardhshëm, me qëllim të absorbimit sa më të mirë të fondeve në dispozicion dhe me qëllim për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë në fushat e mbuluara nga programi i bashkëpunimit ndërkufitar.

Donata von Sigsfeld, Menaxhere Programi për Bashkëpunim Territorial në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Malin e Zi, tha se bashkëpunimi rajonal është lart në agjendën e Bashkimit Evropian dhe theksoi se Mali i Zi është shumë i suksesshëm në menaxhimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar dhe se ka treguar kapacitete të konsiderueshme në menaxhimin e programeve të cilat janë nën menaxhimin indirekt.



Pas fjalimeve hyrëse, drejtuesja e Sekretariatit të Përbashkët Teknik, **Sanja Todoroviq**, prezantoi qëllimet e Thirrjes së Dytë, shumat në dispozicion, si dhe rregullat e përgjithshme për dorëzimin e projekteve nga përfituesit potencial. Në konferencë morën pjesë rreth 100 pjesëmarrës, përfaqësues të bashkive / komunave, institucioneve dhe ndërmarrjeve kombëtare dhe lokale, institucioneve arsimore, përfaqësues të sektorit civil dhe përfaqësues të strukturave operative të programit nga

Mali i Zi dhe Shqipëria, si dhe përfaqësues të mediave. Brenda Thirrjes së Dytë për Propozime, aplikantët potencialë do të jenë në gjendje të dërgojnë projekt-propozime në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e punësimit.

Sesionet informuese në kuadër të programit Mal i Zi -Kosovë

Në sesionet informuese të mbajtura në Gjakovë, Pejë, Kollashin dhe Ulqin, të organizuar me qëllim prezantimin e Thirrjes së Dytë për dërgimin e projekt-propozimeve në kuadër të Programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë u njoftua më shumë se 2 milionë euro janë në dispozicion të përfituesve potencialë për projekte të përbashkëta të Malit të Zi dhe Kosovës në fushën e punësimit dhe turizmit.



„Shuma indikative e fondeve të cilat janë në dispozicion për Thirrjen e Dytë, e cila është e hapur për dërgimin e projekt-propozimeve deri më 15 prill të vitit 2019, është 2.04 milion euro dhe përfituesit potencialë mund të konkurojnë me projekte brenda prioriteteve tematike të lidhura me punësimin, mobilitetin e punës dhe përfshirjen sociale dhe kulturore përgjatë kufirit, si dhe me promovimin e turizmit, trashëgimisë kulturore dhe natyrore”, u



theksua në sesionet informuese. Gjatë sesioneve informuese u vlerësua se Programi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA Mali i Zi-Kosovë 2014-2020 paraqet një mundësi të madhe për bashkëpunim dhe shkëmbim të përvojave dhe se bashkëpunimi i mirë mes dy vendeve rezultoi në kontraktimin e shtatë projekteve me një vlerë totale prej 2.3 milion euro në kuadër të Thirrjes së Parë. Përfaqësueset e Ministrisë së Financave, si Autoritet Kontraktues i këtij Programi, prezantuan dhe informuan pjesëmarrësit e sesioneve informuese me rregullat e aplikimit në kuadër të Thirrjes së Dytë për dërgimin e projekt-propozimeve. Në sesionet informuese morën pjesë mbi 150 pjesëmarrës, të cilët ishin përfaqësues të institucioneve publike, qeverive lokale, institucioneve arsimore, shoqërisë civile dhe mediave.

Sesionet informuese në kuadër të programit Mal i Zi -Shqipëri

Me rastin e shpalljes së Thirrjes së dytë për dërgimin e projekt-propozimeve në kuadër të programit IPA BNK Mal i Zi- Shqipëri, Zyra për Integritet Evropian të Malit të Zi në bashkëpunim me Drejtorinë për Financimin dhe Kontraktimin të Asistencës së BE-së nga Ministria e Financave e Malit të Zi dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Republikës së Shqipërisë, nën mbështetjen e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programit, kanë organizuar katër sesione informuese.



Në sesionet informuese të mbajtura në Plavë, Tivar, Shkodër dhe Lezhë, përfaqësueset e Ministrisë së Financave, si Autoritet Kontraktues të këtij Programi, prezantuan dhe informuan pjesëmarrësit e sesioneve informuese me rregullat e aplikimit në kuadër të Thirrjes së Dytë për dërgimin e projekt-propozimeve.

Në sesionet informuese, në mes të tjerave, u theksua se shumica indikative e fondeve të cilat janë në dispozicion për Thirrjen e Dytë është 2.8 milion euro dhe përfuturit potencial mund të konkurojnë me projekte brenda prioritetëve tematike të lidhura mbrojtjen e mjedisit, promovimin e ndryshimeve klimatike dhe masave për zbutjen e tyre, menaxhimin dhe parandalimin i reziqeve, si

dhe me punësimin, mobilitetin e punës dhe përfshirjen sociale dhe kulturore përgjatë kufirit. Gjatë sesioneve informuese u vlerësua se Programi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020 paraqet një mundësi të mirë për bashkëpunim dhe shkëmbim të përvojave, si dhe për përmirësimin e cilësisë dhe standartit jetësor të zonave ndërkufitare. Në sesionet informuese morën pjesë mbi 150 pjesëmarrës, të cilët ishin përfaqësues të institucioneve publike, qeverive lokale, institucioneve arsimore, shoqërisë civile dhe mediave.



Takimi i Shtatë i Komitetit të Përbashkët të Projektit u mbajt në Budva

Takimi i Shtatë i Komitetit të Përbashkët të Projektit u mbajt me 31 janar të vitit 2019 në Budva (Mal i Zi). Në takim morën pjesë përfaqësuesit e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Mal të Zi dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Zyrës për Integritet Evropian të Malit të Zi, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë si dhe të Sekretariatit të Përbashkët Teknik të programeve të bashkëpunimit ndërkufitarë IPA Mali i Zi-Shqipëri dhe Mali i Zi-Kosovë 2014 – 2020.



Gjatë takimit u diskutua mbi zbatimin dhe mbi aktivitetet e ardhshme gjatë pjesës së parë të vitit 2019 në kuadër të Programeve të bashkëpunimit ndërkufitar IPA Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi – Kosovë 2014-2020. Antarët e Komitetit të Përbashkët të Projektit, kanë diskutuar mbi planifikimin dhe kornizën kohore lidhur me hapjen e thirrjes së dytë për projekt-propozime në kuadër të IPA programeve të bashkëpunimit

ndërkufitarë Mali i Zi-Shqipëri dhe aktivitetet e ardhshme në Programin Mali i Zi-Kosovë. Gjithashtu, gjatë takimit u vlerësua cilësia e aktivitetëve të zbatuara dhe rezultateve të arritura gjatë pjesës së dytë të vitit 2018.

Ditë informuese/Forum për kërkimin e partnerëve për projekte

Në janar të vitit 2019 Sekretariati i Përbashkët Teknik i Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 në bashkëpunim me Strukturat Operative ka organizuar një seri aktivitetesh para shpalljes së Thirrjes së Dytë për dërgimin e projekt-propozimeve në kuadër të programit IPA BNK Mali i Zi – Kosovë 2014 - 2020.



Në kuadër të aktivitetëve përgatitore që zbatohen para publikimit të Thirrjes së Dytë për dërgimin e projekt-propozimeve në kuadër të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë 2014-2020, Dita Informuese/Forumi për kërkimin e partnerëve për projekte u mbajt në Podgoricë me datën 11 Janar të vitit 2019. Në eventin morën pjesë 35 përfaqësues të komunave, organizatave jo-qeveritare, institucioneve arsimore dhe institucioneve tjera nga të dy vendet.



Qëllimi i eventit ishte informimi i pjesëmarrësve rreth Programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë 2014-2020, parimeve të bashkëpunimit ndërkufitar dhe përmbajtjes së përgjithshme të paketës së aplikimit. Pjesëmarrësit morën pjesë në punëtori tematike varësisht nga interesi i tyre, gjë që i mundësoi atyre të ndajnë idetë e projektit, të identifikojnë partnerët potencialë, të shkëmbejnë kontakte dhe të krijojnë bazat për partneritete potenciale në të ardhmen me aplikantë nga ana tjetër e kufirit.

» Strukturat Operuese të programit
(klikoni tek ikona për të shkuar tek web
- faqja)



European Integration Office



Ministry of finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik
E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat
E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti me Specializim në Komunikim
E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti me Specializim në IT
E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ
E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Andi ÇEKAJ

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**
Adresa: Agim Ramadani, 36/4, 10 000 Prishtinë, Kosova
Telefon: +383 38 222 202

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian